

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-1

M 98

Avni R. Mulaj

Valbona e kalitër

poezi

8JH-1
M198

AVNI R. MULAJ

VALBONA E KALTËR

poezi

PUBLIOTERA E R.
GJIROKASTER

JA INV. ~~6496~~

13729

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRI I KALIBRIT

3814

VALBONA E KALIBRIT

1980

Kopertina nga: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 1.500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974

B J E S H K Ë T

E si mund të hesht, e si mund t'i harroj
bjeshkët e mia, nëna të fëmijnisë sime!

Shtruar në qilima të gjelbër pa fund,
jam endur nëpër to, gjithnjë duke u rritur,
gjithnjë një qafë a një pllajë më tutje.
Natyre e pafundme me udhë të pafundme!

Dhe kam ndjerë se diçka është formuar tek unë,
prej fëshfërimës së barit, gjethit e halës së pishës,
prej gurgullimës së ujërave, motit të qetë dhe

stuhisë,
prej vetmisë së shpellave e formës së shkëmbinjve,
prej tingullit të lahutës, zërit të rapsodit,

dhe heshtjes së gurit, mbi të cilin vështrimi im
dallon duar stërgjyshërish duke lëvizur e duke

ngritur
atë diçka të madhe që quhet shqiptare
dhe që s'e shembi dot asgjë.

XHAKETA ME MËNGË TË SHKURTËRA

Shpeshherë e shihnim fotografinë e vëllait
me nënën, me babanë e me motrat në mbrëmje,
dhe nënës sytë i turbulloheshin papritur,
dhe sytë e vëllait na shihnin përmallur të gjithë,
sepse diku larg i duhej të kalonte dimrin si nxënës
me një xhaketë të vjetër me mëngë shumë të
shkurtëra,
që nuk arrinin krahët t'ia mbulonin plotësisht.

Dhe sytë e nënës nguleshin te llërët e mbetura
jashtë,
oh, ç'i thoshin vallë nënës ato dy duar në heshtje?
Kështu atëherë, nënë, kishim shumë zehle
ne dhe atdheu që sapo kish fituar lirinë...

Por shpejt u rritëm duke ndarë hallet bashkë
me atdhenë

dhe mëngët e xhaketave të plota tani na rrinë mirë
dhe pas rrudhave e thinjave shohim Shqipërinë
industriale...

Vëlla, u rritëm, por ajo fotografi na mbeti si
kujtim,
ato dy mëngë të shkurtëra, të dhemshura, të dashura.

KOMUNA E PARISIT

Fjeti Komuna,
në gjinë e saj historia e mbështolli.
Komuna fjeti e lumtur,
më e lumtur seç kish qenë Parisi gjithmonë,
me misteret e tij, për të cilat njihet në botë,
më e lumtur seç kish qenë bota ndonjëherë.
Komuna u varros e pavarrosshme,
Komuna lindi që padrejtësitë të varroste.
Përpara murit të vjetër të urryer të shtypjes,
u pushkatuan komunarët,
fëmijët më të bukur të botës,
dhe më të qeshur dhe më të përgjakur!
E ngelën ashtu në kujtesën e botës,
si vetë drejtësia, të pamposhtur!

NË PRAG TË VITIT TË RI

Kaq shumë fëmijë u shfaqën papritur në qytet,
përzier me kukllat, saqë zor t'i dallosh kukllat
nga fëmijët,

kaq shumë gëzim u shfaq papritur kudo,
saqë zor t'i dallosh të mëdhenjtë nga të vegjlit.

Po fëmijët sot s'përmbahen: Viti i Ri, Viti i Ri!
Gëzimi i tyre kërkon të sundojë mbi çdo gjë.

Ata duan të jenë kudo, konduktorë nëpër trena,
duan të ngasin avionët, trenat, nëndetëset.

Fëmijët nëpër dhomat e mbushura me kuklla,
me makina e kafshë të zbutura,

që jetojnë me njerëzit në harmoni.

Dhe qyteti si një xhungël,

ku ndizen në mënyrë përrallore,
milionat llambushka shumëngjyrëshe,

qindra herë fëmijët pyesin: «Kur do të vijë Viti
i Ri?»

T'ju thoni: «Në 12.»

Pyesin sërish: «Si do të vijë?»

Por asnjë përgjigje s'ua ka gjetur shpirtin krejt.
Dhe mua të lumtur më bën ndjenja e tyre,
me të cilën ndjekin akrepin e madh e shajnë të
voglin,
dhe në puqjen e tyre shoh botën e madhe
nën miliona vështrime të fëmijëve...

MOS E LEJO...

Mos e lejo kurrë zemrën të rrahë për gjëra të kota,
sepse nga dashuria e vërtetë ke hequr ca të rra-
hura,
mos hidh kurrë hapa në një rrugë pa qenë i ven-
dosur,
sepse shumë vonë i penduar rëndë do të kthehesh,
mos dil kurrë të presësh një vajzë që edhe mund
të mos vijë,
sepse mund të ngelesh i vetëm në një çast që nuk
duhet të ngelësh.